



## **VENDIM MBI PAPANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 2 shkurt 2015**

**Numri i lëndës: 2014-26**

**Ajet Kaçiu**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 2 shkurt 2015, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar më 4 prill 2014.

### **II. FAKTET**

2. Siç janë paraqitur nga ankuesi, faktet e lëndës mund të përmbliidhen si në vijim.

3. Ankuesi ka punuar si inspektor i policisë tatimore në Prishtinë deri më 27 shkurt 1999, atëherë kur ishte larguar nga Kosova drejt Shqipërisë.
4. Ai ishte kthyer në shtator të vitit 1999 dhe ishte përpjekur pa sukses të rifilloj punën e tij si inspektor tatimor.
5. Në një datë të pasaktësuar të vitit 2001, ai kishte parashtruar një ankesë kundër Autoritetit Qendror Fiskal (një organ fiskal i themeluar nga UNMIK-u në fund të vitit 1999) pranë Gjykatës Komunale të Prishtinës, duke kërkuar që të rikthehej në pozitën e tij të punës.
6. Më 2 prill 2003, Gjykata Komunale ka refuzuar ankesën. Ajo kishte gjetur se Autoriteti Qendror Fiskal nuk kishte ndonjë status ligjor në procedurë.
7. Më 26 maj 2003, sipas ankesës së ankuesit, Gjykata e Qarkut e Prishtinës kishte anuluar vendimin e shkallës së parë dhe kishte kthyer lëndën në Gjykatën Komunale për rishqyrtim.
8. Më 2 prill 2003, Gjykata Komunale e Prishtinës përsëri kishte refuzuar ankesën e ankuesit, për të njëjtat arsye si më parë. Ankuesi kishte apeluar kundër këtij aktgjykimi.
9. Më 20 prill 2005, Gjykata e Qarkut e Prishtinës sërish kishte kthyer lëndën në Gjykatën e shkallës së parë për rishqyrtim.
10. Më 29 qershor 2006, Gjykata Komunale e Prishtinës ka pranuar ankesën e ankuesit dhe kishte rikthyer atë në pozitën e tij si inspektor tatimor.
11. Më 7 shtator 2006, Administrata Tatimore e Kosovës (e cila kishte zëvendësuar Autoritetin Qendror Fiskal) kishte parashtruar një ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës.
12. Nga materiali i parashtruar nga parashtruesi i ankesës nuk është e qartë se çfarë ka qenë rrjedha e mëtutjeshme e ngjarjeve në këto procedura.
13. Më 24 gusht 2009, ankuesi ka marrë një letër nga një gjykatës i EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, me sa duket në përgjigje të "ankesës së tij të datës 9 prill 2009" (përmbajtja e kësaj ankese nuk është përshkruar). Në letrën e tij, gjykatësi ka njoftuar ankuesin se, pasi që lënda e tij që kishte të bënte me një kontest pune, në bazë të ligjit Nr. 03/L-053 mbi Ligjin mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, ka dalë jashtë juridiksionit të EULEX-it. Më tutje ai ka deklaruar se nuk kishte asnjë shenjë se do të mund të kishte ndonjë parregullsi gjatë shqyrtimit të lëndës së ankuesit pranë Gjykatës Supreme dhe se EULEX-i nuk e kishte në plan ta monitoroj atë.

### III. ANKESAT

14. Ankuesi kërkon që "EULEX-i të jetë i drejtë gjatë shqyrtimit të lëndës së tij". Më tej, ai kërkon kompensim për periudhën, gjatë së cilës kishte mbetur i papunë.

### IV. LIGJI

15. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
16. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
17. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.
18. Paneli konstaton se ankesa e ankuesit ka të bëjë me një kontest pune ndërmjet tij dhe Autoritetit Tatimor të Kosovës. Paneli përsërit se në bazë të rregullës 25, paragrafit 1, bazuar në konceptin e llogaridhënies në OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë, në parim Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Paneli nuk ka kompetencë as në fushën administrative e as në fushën juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Si pasojë, Paneli nuk mund të ndikoj në rezultatin e procedurave gjyqësore apo shpejtësinë me të cilat ankesat në pritje shqyrtohen nga gjykatat e Kosovës. Madje edhe nëse supozojmë se gjykatësit e EULEX-it kanë marrë pjesë në ndonjë prej procedurave në të cilat ankuesi ishte i përfshirë, Paneli prapë e përsëritë se tashmë është konstatuar se edhe pse gjykatësit e EULEX-it janë pjesë e trupit gjykues të ndonjë gjykate të caktuar, nuk do të thotë se ajo gjykatë nuk është pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih në mesin e shumë të tjerëve *Gani Zeka kundër EULEX-it*, 2013-15, 4 shkurt 2014, 4 shkurt 2014 § 13; *Shaban Kadriu kundër EULEX-it*, 2013-27, 27 maj 2014, § 17).

19. Ankesa e parashtruar në EULEX e përmendur në par. 11 nuk ka prekur juridiksionin e Panelit në mënyrë që shqyrtohet lënda si çështje që bie në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it. Atëherë kur gjykatësi i EULEX-it i është përgjigjur ankesës, ai nuk ka ushtruar autoritet ekzekutiv në kuptim të Konceptit Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (për shembull krahasoni *Hamiti kundër EULEX-it*, 2012-01, 5 qershor 2012 § 17 apo *Shaban Kadriu*, cituar më lartë, § 18).
20. Si pasojë, kjo ankesë bie jashtë kompetencës së Panelit, siç saktësohet në rregullin 25 të rregullores së vetë të punës dhe të OPLAN-it të EULEX-it Kosovë.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës, dhe

#### **SHPLL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

Joanna MARSZALIK  
Zyrtare e lartë ligjore



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese